



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORATI

Tiranë, më 17.06.2019

**UDHËZUES**

**PËR PROCEDURAT E ADMINISTRIMIT TË PROJEKTEVE  
TË KËRKIMIT SHKENCOR QË FINANCOHEN NGA BUXHETI PËR KËRKIMIN  
SHKENCOR NË UNIVERSITETIN E TIRANËS.**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Universitetit të Tiranës, për realizimin e projekteve kërkimore dhe konferencave shkencore me fondet e njësisë kryesore:

**UDHËZOJMË**

Projektet e kërkimit shkencor, që financohen në çdo Departament, nga buxheti i njësisë kryesore për shkencën, mund të propozohen nga njësitë bazë, grupet kërkimore dhe kërkues të veçantë të tyre, vetëm apo në bashkëpunim.

Projektet e propozuara duhet të mbështesin dhe të synojnë arritjen e objektivave të kërkimeve shkencore në fushat e përcaktuara nga çdo Departament dhe mund të zgjasin për një periudhë deri në dy vit.

Administrimi dhe financimi i projekteve, në kuadrin e kërkimit shkencor të njësisë kryesore, kalon përmes këtyre etapave dhe procedurave:

1. Përcaktimi i fushave përparësore të kërkimit shkencor nga njësitë kryesore bazuar në propozimet nga njësitë bazë duke marrë në konsideratë strategjitë dhe politikat e UT në fushën e kërkimit shkencor.
2. Thirrja për paraqitjen e projekt - propozimeve.
3. Paraqitja e projekt – propozimeve; kontrolli formal dhe vlerësimi.
4. Përcaktimi i projekteve fituese dhe lidhja e kontratës.
5. Monitorimi dhe raportimi i rezultateve.

## **1. Thirrja për paraqitjen e projekt - propozimeve**

Thirrja për paraqitjen e projekt-propozimeve, e cila shpallet nga Drejtuesi i njësisë kryesore, ka për qëllim të ftojë anëtarët e personelit akademik, të paraqesin projekt-propozime në kuadër të kërkimit shkencor.

Thirrja duhet të përmbajë:

1. Fushat përparësore të kërkimit shkencor të njësive kryesore.
2. Kohëzgjatjen e projektit.
3. Datën përfundimtare të dërgimit të projekt-propozimeve.
4. Adresën e dërgimit të projekt-propozimeve.
5. Ndarja e fondit të kërkimit shkencor sipas njësive bazë të miratuar nga Dekanati.



Thirrja duhet të dërgohet zyrtarisht në të gjitha departamentet dhe qendrat e kërkimit të fakultetit, si dhe të publikohet on-line në faqen e fakultetit, të paktën, dy muaj përpara datës përfundimtare të pranimit të projekt-propozimeve.

## **2. Procedura e aplikimit dhe përzgjedhjes së projekteve**

Projekt-propozimi, shoqëruar me një kërkesë për financim të drejtuesit të grupit kërkimor, i paraqitet përgjegjësit të njësive bazë. Projekt-propozimi duhet të hartohet në përputhje me kërkesat e Formularit të Aplikimit të projektit për kërkimin shkencor të njësive kryesore. (Aneksi 1) dhe duke mbajtur parasysh sqarimet përkatëse (Aneksi 2) bashkëngjitur këtij formulari. Projekt-propozimi paraqitet në dy kopje.

Departamenti vlerëson projekt-propozimet e paraqitura dhe në një mbledhje të veçantë të tij përzgjedh projektet fituese. Përgjegjësi i departamentit e përcjell vendimin e departamentit për miratim nga Dekanati.

## **4. Përcaktimi i projekteve fituese**

Dekanati miraton projektet e përzgjedhur nga departamenti përkatës dhe bën shpalljen e projekteve fitues.

## **5. Lidhja e Kontratës**

Për projektet fituese që miratohen për financim, lidhet kontrata sipas modelit të Aneksit 3. Kontratat lidhen ndërmjet përgjegjësit të departamentit, drejtuesit të projektit dhe administratorit të njësive kryesore.

## **6. Monitorimi dhe raportimi i rezultateve**

Monitorimi i ecurisë së projekteve kryhet nga Njësia bazë.

Drejtuesi i projektit harton dhe dorëzon në departament një raport periodik të ecurisë së projektit në mes të kohëzgjatjes së përgjithshme të projektit (nëse projekti zgjat 1 vit, raporti dorëzohet në përfundim të muajit të gjashtë). Drejtuesi i projektit merr masa për publikimin e rregullt të aktiviteteve dhe rezultateve të projektit.

Për rezultatet e arritura në projekt, drejtuesi i grupit kërkimor i paraqet njësisë bazë në datën 20 dhjetor të vitit përkatës raportin përfundimtar pas mbylljes së projektit.

Departamenti i përcjell Dekanatit raportin përfundimtar për projektet e realizuara. Lista e të gjitha projekteve të realizuara dhe një përmbledhje e shkurtër (jo më shumë se 1 faqe) përcillen në Rektorat.







UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI \_\_\_\_\_  
DEPARTAMENTI \_\_\_\_\_

---

**FORMULARI I APLIKIMIT NË PROGRAMIN PËR  
KËRKIMIN SHKENCOR**

Tiranë, korrik 2019



1. Departamenti ( Qendra) përfitues:

2. Titulli i Projektit:

3. Afati:

Kohëzgjatja në muaj:

---

4. Personeli i Projektit:

A. Drejtuesi i Projektit:

4/A. Fusha (fushat) e ekspertizës të drejtuesit të projektit:

- 1.
- 2.
- 3.

4/B. Bashkëpunorët:

Emri:                      Mbiemri:                      Institucioni

*C. Personeli tjetër*

Nr.	Emri	Profesioni dhe kategoria e pagës
1.		
2.		
3.		
4.		



---

5. *Argumentimi i Projektit.* (Nëse vendi më poshtë është i pamjaftueshëm, shtoni fletë tjetër. Kjo edhe për pikat që vijojnë më tej).

*A. Gjendja aktuale: (Punime, ose publikime shkencore, të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë, që përbëjnë bazën mbi të cilën ngrihet argumentimi praktik ose shkencor i projektit)*

---

*B. Punimet shkencore të kryera deri tani:*

---

*C. Objektivat e projektit dhe rezultatet e pritshme:*

---

*D. Përfituesit nga projekti:*

*1. Përfituesit direktë:*

*2. Përfituesit indirektë:*

---



---

*E. Plani i punës, përfshirë metodologjinë dhe teknikat që propozohet të përdoren:*





6. Buxheti. Vlerësimi i projektit në Mijë Lekë.

*A. Honorar*

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.		
2.		

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

*B. Materiale (konsumi) e Furnitura*

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.		
2.		

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

*C. Shërbime Bazë*

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.		
2.		

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

*D. Shpenzime Transporti*

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.		
2.		

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

*E. Shpenzime të tjera operative*

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.		
2.		

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

*F. Shpenzime Udhëtimi*

Nr.	Emërtimi	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë
1.		
2.		

Totali i pjesshëm në Mijë Lekë :

Totali në Mijë Lekë		
---------------------	--	--

Drejtuesi i Projektit

Përgjegjësi i Departamentit

Firma:                      Data:

Firma:                      Data:



**Sqarime për plotësimin e Formularit të Projektit shkencor në Fakultetin \_\_\_\_\_, Universiteti i Tiranës.**

Plotësimi i saktë i Projektit për kërkimin shkencor sipas kërkesave të Modelit të dhënë më sipër ka rëndësi të veçantë, sepse mbi këtë dokument bazohet zgjedhja ose refuzimi i projekt-propozimit për financim.

Për plotësimin e tij të duhet të mbahet parasysh sa vijon:

- Pika 1 - Departamenti apo njësia, që merr përsipër të gjitha detyrimet për realizimin në kohë e me cilësi të projektit.
- Pika 2 - Jepet titulli i projektit, i cili duhet të shprehë në mënyrë sintetike objektin e studimit (jo më shumë se 200 karaktere).
- Pika 3 - Jepet *afati* i realizimit të projektit, duke shënuar kohën e fillimit (muaji, viti) dhe të përfundimit të tij (muaji, viti). Jepet gjithashtu *kohëzgjatja* e projektit në muaj.
- Pika 4 - Jepet përbërja e grupit kërkimor që do të realizojë projektin, duke përfshirë edhe kërkuesit e institucioneve bashkëpunëtoare. Drejtuesi i grupit kërkimor duhet të jetë një dhe i vetëm.
  - Pikat 4/A&B – Jepet fusha e ekspertizës së drejtuesit të projektit dhe të bashkëpunëtorëve.
  - Pika 4/C - Jepet personeli ndihmës i projektit.
- Pika 5 - Sqarohen arsyet e ndërmarrjes së studimit dhe bëhet argumentimi i plotë dhe i qartë i projektit shkencor.
  - Pika 5/A - Bëhet identifikimi i problemit dhe argumentohet rëndësia e zgjidhjes së tij ku duhet të sqarohen çështje të tilla si:
    - ◆ gjendja e deritanishme ose njohja e problemit para ndërmarrjes së projektit;
    - ◆ arsyet përse ndërmerret projekti dhe çfarë synohet të arrihet;
    - ◆ të rejat që pritet të sjellë projekti në planin shkencor;
    - ◆ përveç institucionit që ndërmerr studimin, kujt tjetër i interesojnë rezultatet e pritëshme të projektit për zbatim etj;
  - Pika 5/B - Jepen punimet shkencore të kryera deri tani në këtë fushë ose që janë në proces nga institucione të tjera shkencore, si dhe lidhja që ato kanë me projektin që do të ndërmerret, me qëllim që të shmanget përsëritja ose kryerja e punëve paralele.
  - Pika 5/C – Jepen objektivat e projektit dhe rezultatet e pritshme. *Objektivat* që përbëjnë synimet thelbësore të projektit, duhet të formulohen si qëllime, të jenë të shprehura në mënyrë të përmbledhur dhe





- saktë. Arritja e tyre duhet të shprehet me rezultate të matshme e të kontrollueshme, që mund të arrihen me aktivitete brenda mundësive të financimit, kohës, forcave njerëzore e materiale të disponueshme. Për çdo objektiv të jepen rezultatet e pritshme që justifikojnë arritjen e tij. Çdo objektiv mund të ketë një ose disa rezultate.
- Pika 5/D - Jepen *përfituesit* nga projekti, që ndahen në *direkt* dhe *indirekt*. Përfituesit direktë janë ata që mbështeten direkt nga fondet e projektit, ndërsa përfituesit indirektë janë ata që mund të përfitojnë nga rezultatet e zbatimit të projektit. Jepen gjithashtu rrugët që mendohet të ndiqen për t'i bërë të njohura rezultatet e projektit për të gjithë përdoruesit e mundshëm të tyre – botime shkencore, seminare, vidiokaseta, fletë palosje, reklama komerciale, etj. Aktivitetet kryesore që lidhen me to dhe që mendohet të zhvillohen brenda afatit të projektit, duhet të parashikohen në planet e punës (shih pika 5/F).
  - Pika 5/E – Jepet plani i detajuar i punës i ndarë në periudha kohore. Në këto plane pasqyrohen aktivitetet që do të kryhen për të arritur rezultatet e kërkuara dhe, për rrjedhojë, objektivat e parashikuara. Çdo rezultat duhet të mbështetet të paktën nga një aktivitet. Gjatë përshkrimit të aktiviteteve duhet të jepen edhe metodat e teknikat kryesore që do të aplikohen për realizimin e tyre. Për çdo aktivitet përcaktohet kohëzgjatja (muaj, javë, etj.) dhe përcaktohet personi/personat përgjegjës për realizimin e tij.
- Pika 6 - Paraqitet ndarja e fondeve (shpenzimeve) sipas zërave të veçantë të tabelës bashkëngjitur mbi përdorimin unik të artikujve të klasifikimit buxhetor ku:
- \* Në artikullin "*Honorar*" përfshihen shpenzimet që u jepen anëtarëve të grupit të projektit, për përqindjen e kohës së punës.
  - \* Në artikullin "*Materiale e furnitura*", përfshihen të gjitha shpenzimet për blerje materiale kryesore e ndihmëse për zyrat, duke përfshirë dhe shpenzimet për inventarin e imët, si dhe shpenzimet për marrje ose përgatitje kampionesh, kryerje analizash ose provash, ruajtje materiali gjenetik e shpenzime të tjera të kësaj natyre.
  - \* Në artikullin "*Sherbime baze*" përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen e objekteve specifike, aparaturave, paisjeve teknike, veglave të punës. Përgatitje apo rifreskim të softeve, faqe interneti (Ëeb site), etj.
  - \* Në artikullin "*Shpenzime transporti*" përfshihen shpenzimet për karburant, etj.
  - \* Në artikullin "*Shpenzime të tjera operative*" përfshihen pagesa të ndryshme, për pjesmarrje në konferenca, seminare, shkëmbime eksperience, etj., brenda vendit etj;
  - \* Në artikullin "*Shpenzime Udhëtimi*" përfshihen shpenzimet për dieta, transport dhe fjetje sipas dispozitave në fuqi për dietat.



## K O N T R A T Ë

### PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË KËRKIMIT NË KUADËR TË FONDIT TË SHKENCËS

Sot, më datë ....., në Tiranë, ndërmjet: Z.Znj. ...., Përgjegjës i departamentit ....., Z.Znj. .... drejtues i projektit dhe Z.Znj. ...., Administrator i Fakultetit ..... lidhet kjo kontratë për financimin e projektit me titull:

.....  
.....  
..... për vitin .....

1. Projekti do të financohet me \_\_\_\_\_(shuma me fjalë) lekë
2. Financimi i projektit do të bëhet konform pasqyrës përkatëse të financimit.

Nr. i artikullit	Emërtimi i artikullit	Nga Fondi i Shkencës	Gjithsej
600	Honorar		
602 1	Materiale (konsumi) e Furnitura		
602 3	Shpenzime transporti		
602 4	Shpenzime udhëtime		
602 5	Shpenzime Baze		
602 6	Shpenzime të tjera operative		
	<b>Totali</b>		

3. Në fund të periudhës kohore të parashikuar në këtë kontratë drejtuesi i projektit duhet të paraqesë një Raport për ecurinë e projektit, realizimin e tij, etj.

Kontrata u përpilua në tre kopje me vlerë të barabartë. Secila palë mban një kopje.

Drejtuesi i Projektit      Përgjegjësi i departamentit      Administratori